



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2018:050271

Datë: 20.01.2021

Numri i dokumentit: 01426425

P. Nr.100 /2018

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore ne Pejë – Dega ne Klinë, Departamenti i përgjithshëm penal, me Gjyqtarën Sabrije Rraci me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Zymer Metaj ne çështjen penale kundër te pandehurit O. (S.) R., ngarr.nr.18/15, për shkak të veprës penale “Asgjesim apo dëmtim i pasurisë” nga neni 333 par. 1 të KPPK –së duke vendosur lidhur me aktakuzën ne Pejë PP nr. 1053/2018 e dt.29.06.2018, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar 28.12.2020, ne prani te prokurorit te shtetit Ersan Qavolli, dhe te të pandehurit O. R., publikisht e shpalli aktgjykimin ndërsa e përpiloi me dt. 20. 01.2021 këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: O. R., i lindur me dt., ne tani me banim ne rr.nr.18/15, nga babai S. dhe nëna N. e vajzërisë H., ka te kryer fakultetin ekonomik, i martuar baba i dy femijeve, i gjendjes së mesme ekonomike identifikohet me nr.Personal:....., posedon nr. te telefonit Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës, mbrohet ne liri.

ËSHTË FAJTOR

Per shkak se:

Me date 20.05.2018 rreth orës 19:30, në perkatesishtë ne asgjëson dhe dëmton pasurin e personit tjetër ne atë menyre qe pas përfundimit te ndeshjes futbollistike KFdhe KF e zhvilluar ne stadiumin në, i pandehuri si tifoz i kubit futbollistik te Prishtinës (.....) pasi qe vendoset ne autobusin e tifozëve dhe niset për në drejtim te Prishtinës, me te arritur ne vendin e ngjarjes, i njëjti zbrit nga autobusi dhe e sulmon veturën me targa te cilin ishte duke e drejtuar i dëmtuari R. R. tifoz i KF duke ja thyer xhamin e prapëm me çka i shkakton dëm material te dëmtuarit.

Me qka ka kryer vepër penale “Agjesim apo dëmtim i pasurisë” nga neni 321 par.1 të KPRK-së

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,41, 46 dhe 73 si dhe nenit 321 par. 1 të KPRK-se, të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së.

G J Y K O N

DËNIM ME GJOBE

I. Të akuzuarin: O. R., me dënim me gjobë shuma në vlerë prej 200 (dyqind) Euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në afatin prej 15 (pesëmbëdhjet) ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguan gjobën e lartë shqiptuar me kohë të përcaktuar, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku për 1 (një) ditë burgim do të llogaritet në 20 (njëzet) Euro të gjobës.

II: OBLIGOHET: I pandehuri, të kompensoj paushallin gjyqësor shumën prej 20 (njëzetë) €, si dhe tarifën për kompenzim të viktimave të krimit shumën në vlerë prej 30 (tridhjet) €, gjithësejt 50 (pesëdhjet) Euro, brenda afatit kohor në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

III.UDHËZOHET: Pala e dëmtuar R. R., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë, në këtë gjykatë me PP nr. 1053/2018 e dt.29.06.2018, ndaj të akuzuarit O. (S.) ngarr.nr.18/15, për shkak të veprës penale "Asgjesim apo dëmtim i pasurisë" nga neni 333 par. 1 të KPPK –së.

I pandehuri është sjellë në gjykatë, nga zyrtarët e Stacionit Policor në Prishtinë, Rreshteri policor G. K. dhe Hetuesi policor F. K., pasi ndaj ti gjykata ka lëshuar urdhër me letërrreshtim vendor, i cili është zënë në Aeroportin e Prishtinës.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datën 28.12.2020 në praninë e Prokurorit të Shtetit Ersan Qavolli, i cili para leximit të aktakuzës, bëri rikualifikimin juridik të veprës penale e cila duhet të jetë: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 i Kdit të Ri penal si ligj më i favorshëm për të pandehurin

Të pandehurit iu lexua aktakuza nga ana e prokurorit, pasi i njëjti e kuptoi dispozitivin e aktakuzës, deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barre, i njëjti deklarohet se pendohet për veprën e kryer ndërsa duke vepruar konform nenit 245 par 1 të KPPRK-së, nuk i ka ftuar palët tjera në seancën fillestare.

Edhe Prokurori i shtetit deklaroi, se pajtohet me pranimin e fajësisë, i cili pranim ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe është bere komform dispozitave ligjore, propozoi gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim pranimin e fajësisë, të marr si rrethanë lehtësuese, i njëjti propozoi që i pandehuri të dënohet sipas ligjit.

Pas deklarimit të pandehurit se e pranoi fajësinë, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Gjykata konstatoi se i pandehuri pranon fajësinë në mënyre vullnetare, pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata me aktvendim në procesverbal aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 248 par.1 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit konform nenit 248 par 4 të KPPRK-se.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Andaj nga pranimi i fajësisë dhe provat materiale nga shkresat e lëndës është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ku është vërtetuar se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë elementet e veprës penale "Asgjesim apo dëmtim i pasurisë" nga neni 333 par.1 të KPRK-se.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i pakujdesshëm për veprën penale të kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës, për veprën penale me të cilën është akuzuar.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-se.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata gjeti se i pandehuri ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar e për më tepër ka pranuar fajësinë dhe ka shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer, si dhe është hera e parë që bije ndesh me ligjin.

Rrethanë rënduese Gjykata gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale, ashtu që me këtë veprë penale parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vjet.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pajtim me nenin 38 të KPRK-së, si dhe në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësorë si në dispozitiv të aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par. 3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA KLINË
P.nr. 100/2018 më dt. 20.01.2021

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2018:050271
Datë: 20.01.2021
Numri i dokumentit: 01426425